FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 101 — 14 gusht — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Urdhër i MB nr. 254, datë 26.7.2012	Për delegim kompetence	5487
Vendim i GJK nr. 46, datë 25.7.2012	Me objekt: Konstatimi i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).....	5489
Vendim i GJK nr. 47, datë 26.7.2012	Me objekt: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KP) dhe gjithë dispozitave të tjera të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore.....	5493
Vendim i GJK nr. 48, datë 26.7.2012	Me objekt: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	5508
Vendim i GJK nr. 49, datë 26.7.2012	Me objekt: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 3508, datë 24.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.....	5513

URDHËR
Nr. 254, datë 26.7.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 21.5.2003 "Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë;
2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit;
3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, të këtij urdhri;
4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 322, datë 9.8.2011 "Për delegim kompetence", do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor;
5. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit;
6. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, revokohet;
7. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr._____ Prot. Tiranë, më __. ___. ____

AUTORIZIM

Për përfaqësimin në çështjen civile me:

Paditës: .....

E paditur: .....

Personi i tretë: .....

Objekti: .....

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile dhe të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. ....., datë..... "Për delegim kompetence",

VENDOSA:

Autorizimi e z/znj....., me detyrë....., për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor/në Gjykatën e Apelit/në Gjykatën e Lartë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Isuf Çelaj

VENDIM
Nr. 46, datë 25.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 5.6.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 18 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Rita Gjati, përfaqësuar nga Lulëzim Koka me deklarim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga Ermira Bakalli, me autorizim. Zyra e Përmbarimit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, kërkuesin, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ka punuar si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me dekretin nr. 5824, datë 28.7.2008, të Presidentit të Republikës, ajo është larguar nga kjo detyrë.

2. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me padi me objekt: “Shfuqizimin e dekretit nr. 5824, datë 28.7.2008, të Presidentit të Republikës. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 96, datë 21.10.2009, ka vendosur: “Shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 5824, datë 28.7.008 për shkarkimin nga detyra të prokurores Rita Gjati. Rikthimin e paditëses në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë.”

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 312, datë 11.4.2011, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit.”

4. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, mbi kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin nr. 91, datë 13.9.2011, ka vendosur: “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.”

5. Gjykata e Apelit Tiranë, në datë 12.1.2010, ka lëshuar urdhrin ekzekutiv të vendimit gjyqësor nr. 96, datë 21.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Kërkuesja, në datë 6.5.2011, i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë për fillimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit. Në datën 31.5.2011 nga Zyra e Përmbarimit Tiranë është bërë lajmërimi i Prokurorisë së Përgjithshme për ekzekutim vullnetar, i cili nuk është kryer. Në datën 11.7.2011 është vendosur fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit të mësipërm.

7. Përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë, në datën 23.11.2011, ka qenë se organika e prokurorisë është e plotësuar sa i takon detyrimit për rikthim në punë. Ndërsa, sa i takon detyrimit financiar ndaj kreditorit, në buxhetin e vitit 2012, nuk është miratuar fond shtesë për ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

8. Në datën 6.3.2012, Zyra e Përmbarimit Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhrit për vendosje të sekuestros konservative në thesarin e shtetit për llogarinë e debitorit Prokuroria e Përgjithshme në shumën 3.182.400 lekë. Pas gjithë këtyre veprimeve të kryera nga Zyra e Përmbarimit, ende vendimi gjyqësor i formës së prerë është i paekzekutuar në tërësi të tij, si për rikthimin në detyrë të kërkueses ashtu edhe për pagesën e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

II

9. ***Kërkuesja*** pretendon se gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009, i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi për shkak të refuzimit dhe pasivitetit të organeve kompetente, vendimi i formës së prerë dhënë në favor të saj nuk po ekzekutohet edhe pse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga dhënia e tij.

10. ***Subjekti i interesuar*** gjatë gjykimit parashtroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

10.1 Ankimi i prokurorëve për shkarkim nga detyra shqyrtohen direkt në Gjykatën e Apelit pa kaluar fillimisht nga gjykatat e shkallës së parë. Rrjedhimisht, vendimi nr. 96, datë 21.10.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë konsiderohet si një vendim i shkallës së parë i cili, në rast rekursi, ka fuqi detyruese vetëm pasi të shprehet Gjykata e Lartë. Në përputhje me vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese, llogaritja e afatit të arsyeshëm duhet të fillojë jo në datën kur vendimi merr formë të prerë por në datën kur është lëshuar urdhri i ekzekutimit. Në përputhje me këto kritere subjekti i interesuar, edhe pse ka qenë në pamundësi objektive për shkak të rrethanave dhe parashikimeve ligjore për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009 të Gjykatës së Apelit, ka treguar vullnet të plotë dhe ka bërë përpjekjet e duhura për të ekzekutuar atë vendim.

10.2 Subjekti i interesuar ka nisur të ekzekutojë detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimi gjyqësor, në bazë të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 54, datë 23.3.2012 dhe do të shlyejë përfundimisht këto detyrime brenda një afati sa më të arsyeshëm. Sa i takon detyrimit për kthimin në punë të kërkueses, subjekti i interesuar deklaroi se numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë të prokurorisë nuk është shtuar deri në momentin që u zhvillua seanca gjyqësore para kësaj Gjykate. Organika është e plotësuar dhe prokuroria është në pamundësi për të kthyer në punë kërkuesen, për sa kohë që nuk rritet numri i punonjësve.

III

Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

11. Kërkuesja pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkueses, që prej marrjes formë të prerë të këtij vendimi ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustifikuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

12. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet: nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Gjykata, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet: nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009*).

15. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e tij i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, është theksuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet: nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

16. Gjykata vlerëson se është i pabazuar prapësimi i subjektit të interesuar sipas së cilit detyrimi i këtij subjekti për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë ka lindur vetëm pasi është lëshuar urdhri i ekzekutimit të atij vendimi. Gjykata Kushtetuese, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vlerëson se organet shtetërore nuk duhet t'i kërkojnë personit ndaj të cilit janë debitorë që të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit (*shih vendimin nr. 13, datë 21.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar.

17. Në çështjen konkrete, nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009 të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky vendim është i ekzekutueshëm që nga data 21.10.2009, kur është marrë ky vendim. Gjykata konstaton se deri në momentin e vendimmarrjes së saj vendimi i formës së prerë ende nuk është ekzekutuar plotësisht.

ii) Kompleksiteti i çështjes

18. Gjykata Kushtetuese vëren se çështja objekt gjykimi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji me këtë qëllim.

iii) Sjellja e kërkueses

19. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesja nuk ka kryer asnjë veprim që mund të ketë sjellë vonesa në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Mbështetur në aktet paraqitura nga palët rezulton se kërkuesja që në datën 12.1.2010 ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 96, datë 21.10.2009 dhe në po atë datë i ka kërkuar subjektit të interesuar ekzekutimin e këtij vendimi. Kërkuesja ka vënë në ekzekutim urdhrin e ekzekutimit pasi është lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesja për ekzekutimin e vendimit i është drejtuar në mënyrë të përsëritur disa institucioneve, si: Zyrës së Përmbarimit Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit dhe Presidentit të Republikës.

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkueses nuk ka shkaktuar vonesa në ekzekutimin e vendimit dhe se ajo (kërkuesja) ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të saj për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

iv) Sjellja e autoriteteve publike

21. Mbështetur në deklarimet e palëve gjatë gjykimit dhe aktet paraqitur prej tyre, rezulton se subjekti i interesuar pretendon se mund të ekzekutojë vetëm detyrimet financiare që i ngarkohen nga vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe vijon të mbetet në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuesen në punë.

22. Subjekti i interesuar administroi në gjykim urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 54, datë 23.3.2012. Sipas këtij urdhri, subjekti i interesuar është angazhuar të shlyejë tërësinë e detyrimit financiar ndaj kërkueses, pjesërisht brenda vitit 2012 dhe përfundimisht brenda vitit 2013. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se subjekti i interesuar po tregon vullnet për të ekzekutuar detyrimet financiare që burojnë nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009.

23. Megjithatë, Gjykata vëren që subjekti i interesuar vijon t'i përmbahet qëndrimit, sipas të cilit ai është në pamundësi për të rikthyer kërkuesen në punë për shkak se organika e prokurorisë, siç është përcaktuar me ligj, është e plotësuar dhe nuk ka vende të lira. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Mbështetur në aktet e paraqitura nga palët gjatë gjykimit rezulton se me propozim të subjektit të interesuar janë emëruar me dekrete të ndryshme të Presidentit të Republikës disa prokurorë që më parë ushtronin funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore ose të Drejtorit të Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Më konkretisht, rezulton se me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6749, datë 2.11.2011, janë emëruar 10 prokurorë pranë prokurorive të rretheve të ndryshme. Provohet se asnjë nga këto pozicione nuk i është ofruar kërkueses.

25. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se subjekti i interesuar ka pasur mundësi për të ekzekutuar detyrimin ndaj kërkueses duke e rikthyer atë në detyrë, qoftë pranë një prokurorie të një rrethit tjetër. Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por nuk ka shfaqur deri tani vullnet për të bërë një veprim të tillë, pasi vazhdon të shprehë hapur se ndodhet në pamundësi për të ekzekutuar këtë detyrim.

26. Si përfundim, Gjykata konstaton se subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet sjelljes së tij, ka cenuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë në pjesën që parashikon rikthimin në detyrë të kërkueses.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 96, datë 21.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë sa i përket detyrimit për të rikthyer në detyrë kërkuesen.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Admir Thanza, Fatmir Hoxha

VENDIM
Nr. 47, datë 26.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 17.4.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Apelit Vlorë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KP) dhe gjithë dispozitave të tjera të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d”, 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit; prapësimet e subjekteve të interesuara, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 424, datë 24.11.2009, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit P.R. për veprat penale të “falsifikimit ose përdorimit të vulave, stampave ose formularëve” dhe të “falsifikimit të akteve të gjendjes civile” të parashikuara, respektivisht, nga nenet 190/1 dhe 191/1 të KP-së; në bashkim të dënimeve ka vendosur dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe 450.000 lekë gjobë; në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale

(KPP), uljen me 1/3 e dënimit dhe dënimin e të pandehurit, përfundimisht, me 4 (katër) muaj burgim dhe 300.000 lekë gjobë; në zbatim të nenit 59 të KP-së pezullimin e dënimit për dënimin me burgim dhe vendosjen e të pandehurit në provë për një afat 5-vjeçar gjatë të cilit ai të mbajë kontakte me shërbimin e provës një herë në tre muaj dhe të mos kryejë vepër tjetër penale; në zbatim të nenit 34 të KP-së detyrimin e të pandehurit të paguajë gjobën brenda një viti nga data e marrjes formë të prerë të vendimit.

2. Kundër vendimit të lartpërmendur ka paraqitur ankim mbrojtësi i të pandehurit duke pretenduar pezullimin edhe të pjesës së dënimit me gjobë. Ai ka parashtruar se përderisa gjykata ka dhënë dy dënime kryesore dhe njërin prej tyre, dënimin me burgim, e ka pezulluar, duhet të vendoset edhe pezullimi i dënimit tjetër kryesor, atij me gjobë.

3. Gjykata e Apelit Vlorë (gjykata referuese), ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes nr. 594 akti, datë 22.2.2010, me të pandehur P.R. dhe, në mbështetje të neneve 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për t'u shprehur nëse nenet 190 dhe 191 të KP-së dhe gjithë dispozitat e tjera të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore, janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

II

4. ***Gjykata referuese*** pretendon se nenet 190 dhe 191 të KP-së si dhe dispozitat e tjera të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë si sanksione për veprën penale dy dënime kryesore, atë me burgim dhe me gjobë, bien në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer. Ndërsa, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore dhe në thelb të ndryshme nga njëra-tjetra dhe se ndikimi i secilit prej tyre mbi të dënuarin, dhe procesin riedukativ ndaj tij, është shumë i ndryshëm.

5. Gjykata referuese pretendon, gjithashtu, se dispozitat, për të cilat kërkohet kontrolli kushtetues, bien në kundërshtim edhe me nenin 18 të Kushtetutës, i cili sanksionon barazinë e shtetasve para ligjit për këto arsye:

5.1. Së pari, parashikimi për disa vepra penale i dy dënimeve kryesore, në shkelje të standardit të sanksionuar nga dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal për dhënien ndaj autorëve të veprave penale të një dënimi kryesor, vë në pozita të pabarabarta subjektet e veprave penale që për të njëjtën arsye, shkeljen e ligjit penal, i nënshtrohen një dënimi kryesor;

5.2. Së dyti, në disa prej dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal (si p.sh. neni 189 dhe 248) nuk ka raport të drejtë midis minimumit dhe maksimumit të sanksionit të parashikuar për dënimin me burgim në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal (neni 34/1 i KP-së) dhe minimumit dhe maksimumit të sanksionit të parashikuar për dënimin me gjobë në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal (neni 34/3 i KP-së), duke krijuar pabarazi brenda vetë normës.

5.3. Së treti, pamundësia e pezullimit edhe të dënimit me gjobë për subjektet e veprave penale që parashikojnë dy dënime kryesore, krijon pabarazi në aplikimin në thelb të ligjit penal, pasi subjekteve të veprave penale për të cilat është parashikuar dënimi me burgim, për rrethana të tilla si: rrezikshmëria e pakët e personit, mosha, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe e nevojave, mund t'i pezullohet dënimi me burgim, ndërsa të parët, të gjendur në të njëjtat kushte dhe rrethana, nuk kanë mundësinë t'i "shpëtojnë" dënimit penal me gjobë.

6. Po ashtu, gjykata referuese pretendon se nenet 190 dhe 191 të KP-së bien në kundërshtim edhe me nenin 30 të Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e prezumimit të pafajësisë, për arsyen se ligjvënësi ka përcaktuar dënimin me gjobë të autorit të veprave penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve dhe të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, pa konstatuar më parë praninë e motivit të

përfitimit pasuror apo material, që sipas gjykatës referuese është parakusht për vendosjen e dënimit me gjobë, duke e prezumuar kështu fajtor *a priori* subjektin e këtyre veprave penale.

7. Për arsyet e mësipërme, gjykata referuese ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të neneve 190 dhe 191 të KP-së dhe gjithë dispozitave të tjera të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore.

8. Subjekti i interesuar, ***Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,*** ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke paraqitur argumentet e mëposhtme:

8.1. Kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk plotësohen kushtet që legjitimojnë gjyqtarët të investojnë këtë Gjykatë, pasi nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis neneve, antikushtetutshmëria e të cilave çmohet si e tillë nga gjykata referuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga kjo e fundit.

8.2. Lidhur me themelin e çështjes, parashikimi i njëkohshëm si dënim kryesor i gjobës, krahas dënimit me burgim, u realizua me miratimin e paketës së ndryshimeve në Kodin Penal të vitit 2004, e cila u reflektua edhe në nenet 190 dhe 191 të KP-së. Ashpërsimi i masave për këto vepra penale u bë në kuadër të përmirësimit të sistemit ligjor dhe të rritjes së frytshmërisë së institucioneve kompetente për të parandaluar dhe goditur me të gjitha mjetet fenomenet e krimit dhe të trafiqeve, pra në kuadër të luftës kundër kriminalitetit në përgjithësi.

8.3. Pretendimi i gjykatës referuese se në rastin konkret është prekur parimi i proporcionalitetit, nuk qëndron pasi është në kompetencën e ligjvënësit që nëpërmjet akteve ligjore të rregullojë me hollësi të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë. Në nenin 17 të saj thuhet se kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë janë të justifikuara nëse ato bëhen me ligj për interes publik ose për mbrojtjen e të tjerëve. Nenet 190 dhe 191 të KP-së i përmbushin këto kritere.

8.4. Po ashtu, nuk qëndron pretendimi për cenim të neneve 17 dhe 18 të Kushtetutës, sepse parashikimi i dy dënimeve kryesore është në përputhje me sanksionimet e nenit 29 të KP-së. Ky parashikim nuk bie ndesh as me parimet themelore të Kodit Penal dhe kryesisht me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

9. Subjekti i interesuar, ***Prokuroria e Përgjithshme,*** duke e konsideruar kërkesën të pabazuar, parashtroi:

9.1. Kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ekziston një raport i domosdoshëm mes zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së neneve 190 dhe 191 të KP-së nga ana e Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes në shqyrtim nga gjykata referuese, në kuptimin që gjykimi nga kjo gjykatë mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese (lidhja e drejtpërdrejtë).

9.2. Lidhur me themelin e çështjes, pretendimi për cenim të nenit 17 të Kushtetutës nuk është i bazuar, pasi karakteri i drejtë ose jo i një dënimi nuk lidhet me caktimin e një dënimi të vetëm, por ka të bëjë me përputhjen e tij me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

9.3. Nga ana tjetër, caktimi i një dënimi me gjobë, edhe në rastet kur mungon përfitimi material, nuk e bën caktimin e atij dënimi të padrejtë apo jo në përpjesëtim me veprën penale të kryer. Parimi i drejtësisë së një dënimi nuk lidhet me një korrelacion kaq të drejtpërdrejtë mes llojit të dënimit dhe veprës penale, por me sigurimin, brenda respektimit të dinjitetit njerëzor, të një baraspeshimi mes rëndësisë së masës ndëshkuese dhe rëndësisë së veprës penale.

9.4. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi për cenim të nenit 18 të Kushtetutës, sepse koncepti i barazisë përpara ligjit nuk nënkupton vendosjen e të gjithë shtetasve detyrimisht në situata të ngjashme, por përcaktimin në situata të ngjashme të përgjegjësive ligjore të barabarta.

9.5. Parashikimi i dy dënimeve kryesore nga ana e ligjvënësit nuk shkakton asnjë lloj paragjykimi se i pandehuri ka kryer veprën penale (të falsifikimit në rastin konkret) vetëm për motive materiale. Rrethana e përfitimit material është parashikuar si një *conditio sine qua non* për caktimin e një dënimi me gjobë kur vetë dispozita nuk e parashikon dënimin me gjobë, ndërsa, sipas sanksionimit të neneve 190 dhe 191 të KP-së, gjykata nuk detyrohet ta lidhë detyrimisht caktimin e dënimit me gjobë me

praninë e një përfitimi material nga vepra penale. Për këtë arsye nuk cenohet parimi i prezumimit të pafajësisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese
Lidhur me legjitimimin e gjykatës referuese

10. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së normës gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore, duke pasur si parakusht që kushtetutshmëria e normës së referuar të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete.

11. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, nëse kanë arsye të besojnë se zgjidhja e çështjes nga ana e tyre mund të çojë në cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve, atëherë ato janë të autorizuara, nga sanksionimi i normës kushtetuese, që të referojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për zgjidhjen e problemit të kushtetutshmërisë.

12. Në rastin konkret, gjykata referuese ka konstatuar se përcaktimi si dënim për veprat penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve apo të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 190 dhe 191 të KP-së, i dy dënimeve kryesore (me burgim dhe gjobë), bie në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Gjithashtu, sipas gjykatës referuese, dispozitat bien ndesh me nenin 18 të Kushtetutës, i cili sanksionon barazinë e shtetasve para ligjit, dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë të parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës.

13. Gjykata çmon se një konstatim i tillë nga ana e gjykatës referuese ngre *prima facie* probleme kushtetutshmërie të neneve 190 dhe 191 të KP-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave të lartpërmendura.

IV

Lidhur me themelin e kërkesës

14. Gjykata, para se t'u japë përgjigje pretendimeve të gjykatës referuese, nëse dispozitat penale, objekt kontrolli kushtetues, bien ndesh me nenet 17, 18 dhe 30 të Kushtetutës, vlerëson të arsyeshme të analizojë, fillimisht, nën dritën e një këndvështrimi historik dhe krahasues, legjislacionin penal shqiptar lidhur me klasifikimin e dënimeve kryesore dhe plotësuese, kriteret e zbatimit të tyre dhe qëllimet që ndjekin në frymën e parimeve të përgjithshme të Kodit Penal.

15. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë sanksionon dy lloje dënimesh, dënimet kryesore dhe ato plotësuese. Dënimet kryesore janë të parashikuara në nenin 29 të KP-së. Në llojin e dënimeve kryesore, të cilat mund të jepen nga gjykatat e zakonshme më vete, për personat që kanë kryer krime, hyjnë dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe ai me gjobë. Ndërsa për personat që kanë kryer kundërvajtje dënimet kryesore janë dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimi me burgim parashikohet nga neni 32 i KP-së, ndërsa dënimi me gjobë nga neni 34 i KP-së. Përveç dënimeve kryesore, gjykatat kur e çmojnë të arsyeshme, bashkë me dënimin kryesor mund të caktojnë edhe një ose më shumë dënime plotësuese, të parashikuara nga neni 30 i KP-së, në lidhje dhe me nenet 35-43 të tij.

16. Për sa u përket dispozitave objekt shqyrtimi, neni 190 i KP-së, në formulimin e tij fillestar, parashikonte për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve dënimin me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Ndërsa neni 191 i KP-së, për veprën penale të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, parashikonte dënimin me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

17. Me miratimin nga ligjvënësi të një pakete të parë ndryshimesh të Kodit Penal, u realizua, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8733, datë 24.1.2001, parashikimi, fillimisht, i dënimit me gjobë krahas dënimit me burgim, kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. Konkretisht, nenit 34 të KP-së, ndër të tjera, i është shtuar paragrafi i pestë, i cili sanksion se "*për personat që kryejnë krime*

për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita penale parashikon vetëm dënimin me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë nga 100 mijë deri në 5 milionë lekë".

18. Më vonë, me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, ligjvënësi, në kuadër të forcimit të masave kundër kriminalitetit, e pa me vend, që t'i hapë rrugë një sërë ndryshimesh të tjera në legjislacionin penal, të cilat "detyrojnë" gjykatën të vendosë njëkohësisht dy dënime kryesore për kryerjen e një vepre penale. Këto ndryshime nuk mund të realizoheshin pa modifikuar fillimisht dispozitën parimore lidhur me dënimet kryesore, nenin 29 të KP-së. Kështu, me ligjin e lartpërmendur këtij neni iu shtua paragrafi i fundit, me këtë përmbajtje: "*Dënimi me burgim dhe me gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi*".

19. Për rrjedhojë, pas këtij plotësimi, përveç të tjerash, me ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004, ndryshime u bënë edhe në formulimin e neneve 190 dhe 191 të KP-së. Sipas sanksionimit të këtyre të fundit, tashmë, për personat që kryejnë veprat penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve dhe të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, gjykatat vendosin dy dënime kryesore, atë me burgim dhe me gjobë.

20. Parashikimi njëkohësisht i dy dënimeve kryesore u përdor nga ligjvënësi edhe në ndryshimet e mëvonshme të Kodit Penal në vitet 2007, 2008, si dhe në ndryshimet e fundit të miratuara në vitin 2012. Si pasojë, një sërë dispozitash të Kodit Penal, aktualisht, parashikojnë sanksionimin njëkohësisht të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë.

21. Në vijim të kësaj premise, duke qenë se rendet juridike europiane bazojnë përgjithësisht sistemin e tyre të dënimeve mbi një bashkësi figurash ndëshkuese të shumta, Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim, në mënyrë të përmbledhur, përmbajtjen e dispozitave të disa prej këtyre vendeve, duke i krahasuar me dispozitat objekt shqyrtimi.

- Kodi Penal Gjerman, në kapitullin 23 (seksioni 267-282), që bën fjalë për falsifikimin e dokumenteve, parashikon si dënim atë me burgim (në masë të ndryshme dënimi sipas rasteve) ose me gjobë. Ndërsa seksioni 41 parashikon se krahas dënimit me burgim mund të vendoset edhe dënimi me gjobë, duke pasur parasysh edhe gjendjen financiare të autorit të krimit, kur ky i fundit është pasuruar nga kryerja e veprës ose e ka kryer veprën me qëllim përfitimi monetar. Nga kjo dispozitë e fundit, rezulton se elementi i përfitimit material është element i rëndësishëm për përcaktimin njëkohësisht të dy dënimeve.

- Kodi Penal Rumun në nenin 288, që bën fjalë për falsifikimin e dokumenteve zyrtare, parashikon vetëm dënimin me burgim nga tre muaj deri në tre vjet. Ndërsa në rastet e tjera të falsifikimit (falsifikimi i akteve private ose përdorimi i tyre) të parashikuara në nenet në vijim, sanksionohet dënimi me burgim (në masë të ndryshme dënimi sipas rasteve) ose me gjobë.

Në një pozicion të ngjashëm me eksperiencat e paraqitura më lart janë:

- Estonia, nenet 344-347 të KP-së parashikojnë për falsifikimin e dokumenteve dënimin me burgim (në masë të ndryshme dënimi sipas rasteve) ose me gjobë;

- Kroacia, neni 311 i KP-së për falsifikimin e dokumenteve parashikon dënimin me burgim (jo më shumë se tre vjet) ose me gjobë;

- Hungaria, seksioni 274 i KP-së parashikon vetëm dënim me burg (deri në tre vjet) të personit që përgatit një dokument zyrtar të falsifikuar.

- Mali i Zi, neni 414 i KP-së parashikon vetëm dënim me burg (nga 3 muaj deri në pesë vjet) për veprën penale të falsifikimit të një dokumenti zyrtar.

- Serbia, neni 355 i KP-së parashikon vetëm dënim me burg (nga 3 muaj deri në pesë vjet) për veprën penale të falsifikimit të një dokumenti zyrtar.

22. Ndërsa Kodi Penal Francez (seksioni 444/1 i KP-së) dhe Kodi Penal Italian (nenet 467 e vijues të KP-së), për veprat penale në fjalë parashikojnë aplikimin e dy dënime kryesore atë me burgim dhe atë me gjobë.

23. Nga të dhënat e mësipërme, Gjykata konstaton se pjesa më e madhe e legjislacioneve, përfshirë edhe ato të vendeve fqinje, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare

parashikojnë si sanksion një dënim të vetëm, atë me burgim dhe, në rastet kur janë parashikuar dy dënime kryesore ato janë alternative me njëra-tjetrën. Gjithsesi, edhe në ato vende (si p.sh. Italia[1]) ku është parashikuar aplikimi njëkohësisht i dy dënimeve kryesore, tendenca e ligjvënësit, në kuptim të funksionit riedukativ të dënimit, është të diferencojë dënimin penal të të dënuarve duke caktuar një lloj dënimi që është në përpjesëtim me rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

24. Për sa i përket *ratio* të dënimit penal, Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se dënimi penal përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative. Nga njëra anë qëndron funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale, pasi kërcënimi se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo nga shtetasit që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër qëndron funksioni i parandalimit të posaçëm, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij në mënyrë që, pas kryerjes së dënimit, të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar europiane në këtë fushë, ka theksuar se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka vlerësuar se qëllimi i secilit prej dënimeve kryesore të parashikuara në Kodin Penal është i ndryshëm. Dënimi me burgim, duke konsistuar në një privim të lirisë, është konceptuar në të drejtën penale, edhe në kuptim të parimit të *favor libertatitis*, si *extrema ratio*. Pra, duke qenë se dënimi me burgim passjell sakrifikimin maksimal të lirisë personale të personit, kjo e fundit e mbrojtur nga Kushtetuta, ai është konsideruar nga ligjvënësi si masa e fundit shtrënguese si dhe dënimi më i rëndë ndër dënimet kryesore. Ndërsa, dënimi me gjobë lindi si një mënyrë për të shmangur dënimin me burgim, pasi konsiderohej si më e drejtë që personi të mund të paguante një shumë të hollash për vepra që kishin një rrezikshmëri të ulët shoqërore, pa pasur nevojë që të privohej nga liria. Qëllimi i dënimit me gjobë, në frymën e Kushtetutës, duhet rilexuar në kuptimin që funksioni riedukativ, për disa vepra të caktuara penale, mund të përmbushet edhe nga pagesa e një shume të caktuar, pa qenë nevoja që personi të privohet nga liria vetjake (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore dhe në thelb të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe se ndikimi i secilit prej tyre mbi të dënuarin, dhe procesin riedukativ ndaj tij, është shumë i ndryshëm, pasi qëllimi i dënimit me burgim është diametralisht i kundërt nga ai i dënimit me gjobë (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si: pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (shih nenin 1/b të KP-së). Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (shih nenin 1/c të KP-së). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

[1] Në Itali ka pasur ndërhyrje të shumta të ligjvënësit, jo vetëm për zëvendësimin e disa dënimeve kryesore me ato plotësuese, por edhe (me DPR 30 qershor 2000 n. 230) në lidhje me legjislacionin e aplikimit të dënimeve, për t'i dhënë vlerë parimit kushtetues të funksionit riedukativ të dënimit.

29. Si përfundim, nga analiza e mësipërme, Gjykata çmon se nevojat dhe pritshmëritë e kontrollit social të realiteteve të ndryshme sociale duket sikur gjejnë "përkthim" në politikat penale të rendeve juridike të ndryshme sipas strategjive të ndërhyrjes ndëshkuese të karakterizuara nga instrumente me natyrë të ndryshme (ndëshkuese në kuptim të ngushtë, ndaluese apo mbikëqyrëse). Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, nëse domosdoshmëria e sanksionit penal nuk vihet në diskutim, ajo që diskutohet, në rastin konkret, është "strategjia e ndërhyrjes ndëshkuese" nga ana e ligjvënësit për të përmbushur qëllimin e dënimit, funksionin parandalues të tij dhe atë riedukues, të cilat janë dhe funksionet themelore të legjislacionit penal.

30. Bazuar nga sa më sipër, nisur nga natyra e çështjes në shqyrtim, më poshtë Gjykata do të analizojë nëse parashikimi i dy dënimeve kryesore, për veprat penale të parashikuara nga nenet 190 dhe 191 të KP-së, cenon parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17/1 i Kushtetutës.

Për pretendimin për cenimin e nenit 17 të Kushtetutës

31. Lidhur me parimin e proporcionalitetit, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi Gjykata e vlerëson rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në çështjen në shqyrtim, balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë. Është e vërtetë se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio",* Gjykata çmon se ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Parimi i proporcionalitetit rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, në fakt nga vetë thelbi i të drejtave themelore, sidomos i lirisë personale, të cilat duhet të kufizohen nga pushteti shtetëror vetëm në atë masë sa të jetë e domosdoshme për mbrojtjen e interesave publikë. Pra, rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se edhe pse prej kohësh e drejta penale ka detyrën e mbrojtjes së bazave të një bashkëjetese të rregulluar në shoqëri, ajo nuk është mjeti kryesor i mbrojtjes ligjore me gjithë karakterin e saj më të fuqishëm. Si pasojë, përdorimi i saj duhet t'u nënshtrohet kërkesave të parimit të proporcionalitetit. Për këtë arsye, neni 1, paragrafi 1, i Ligjit Themelor Gjerman, përcakton konceptin e thelbit të dënimit dhe raportin e fajit me dënimin, në kuptimin që çdo dënim duhet të jetë në një raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit *(shih vendimet BVerfGE 19,342; BVerfGE 88, 203; BVerfGE 45, 187 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane)*.

34. Në përputhje me parimet e lartpërmendura, të cilat pasqyrohen edhe në legjislacionin penal shqiptar (shih paragrafin 30 të këtij vendimi), dhe me frymën e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 13, datë 29.5.1997, ka çmuar se parashikimi i sanksioneve (dënimeve) fikse bie ndesh me një sërë parimesh të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal, sidomos për mënyrën e caktimit të dënimit, për rrethanat lehtësuese e rënduese (nenet 47-50) dhe i heqin gjykatës mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cunguar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë.

35. Në këtë kuadër, duke qenë se sanksionet penale lejojnë një ndërhyrje intensive tek të drejtat themelore të njeriut, më poshtë Gjykata do të analizojë, nëse parashikimi i dy dënimeve kryesore, diametralisht të kundërta ndërmjet tyre për nga qëllimet që ndjekin, në të njëjtën vepër penale është në

përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar. Pra, e thënë ndryshe, nëse ashpërsia e dënimit (parashikimi i dy dënimeve kryesore), është proporcionale në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

36. Gjykata konstaton se ligjvënësi, në periudha kohore të ndryshme, ka ndërhyrë në legjislacionin penal, si duke përcaktuar vepra të reja penale të dënueshme, ashtu edhe duke ndryshuar llojet e masave të dënimit, për t'iu përgjigjur shqetësimeve të shoqërisë si pasojë e zhvillimit të kriminalitetit, në veçanti krimit të organizuar. Në këto kushte, ligjvënësi ka sanksionuar dy dënime kryesore për autorët e disa veprave penale, duke synuar kështu të jepet drejtësi dhe të mbrohet e drejta e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, por edhe të rritet efektiviteti i masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale, si një mënyrë për të dekurajuar shtetasit që të ndërmarrin veprime në kundërshtim me normat penale.

37. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se ndërhyrje të tilla të ligjvënësit duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t'i shërbejnë më gjerë edhe parandalimit të veprave penale. Gjykata konstaton se eksperienca ka treguar që ashpërsimi joproporcional i sanksioneve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislacionit penal.

38. Gjithsesi, Gjykata çmon se ndonëse ligjvënësi, në përcaktimin e veprave penale dhe llojit të dënimit ka fushë të gjerë veprimi, kjo liri është e kufizuar kur është fjala për vlerësimin e fajit, si element i domosdoshëm i përgjegjësisë penale dhe, në raport me shkallën e tij, për caktimin e llojit dhe masës së dënimit konkret, pasi këto elemente janë të vlerësueshme vetëm nga gjykatat e zakonshme, rast pas rasti.

39. Si pasojë, gjatë përcaktimit të dënimit, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe, nëpërmjet formulimit të sanksionit, t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete. Koncepti i fajit dhe përcaktueshmëria e pasojave juridike janë në një marrëdhënie tensioni njëra me tjetrën, marrëdhënie kjo për të cilën duhet gjetur një balancë funksionale kushtetuese (*shih vendimin BVerfGE 105, 135 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane)*.

40. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale nga njëra anë dhe shkallës së fajit të autorit të saj nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar gjithë elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në mbështetje të këtyre argumenteve mjafton të analizojmë mënyrën se si caktohet dënimi sipas Kodit Penal. Sipas nenit 47 të këtij Kodi, në caktimin e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

41. Gjithashtu, në bazë të formulimit aktual të nenit 34, paragrafi i gjashtë, të KP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 23, datë 1.3.2012, gjykata, në momentin e dhënies së dënimit me gjobë, duhet të hetojë paraprakisht rreth aftësisë paguese të personit, e cila përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to.

42. Si rrjedhojë, përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me heqje lirie në një sërë dispozitash penale, ndërhyn në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin e dënimit.

43. Po ashtu, Gjykata konstaton se deri në hyrjen në fuqi të paragrafit të fundit të nenit 29 të KP-së, i cili parashikon dy dënime kryesore, ligjvënësi ka mbajtur parasysh këtë ekuilibër të domosdoshëm midis parashikimit të llojeve të veprave penale dhe marzheve të dënimit si atribut i tij me individualizimin e veprës penale, shkallës së fajit dhe llojit dhe masës së dënimit, për efekt të përgjegjësisë penale, si atribut ekskluziv i gjykatës. Në këtë linjë ka shkuar edhe plotësimi që iu bë nenit 34 të KP-së, me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, duke i shtuar paragrafin e pestë, i cili i njeh të drejtën gjykatës të caktojë

krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj.

44. Gjykata, gjithashtu, çmon se ligjvënësi, përpara ndërhyrjeve të lartpërmendura, për arritjen e qëllimeve të tij, ka parashikuar, në legjislacionin penal, krahas dënimeve kryesore dhe ato plotësuese dhe, në kuadër të karakterit demokratik të Kodit Penal, si dhe si shprehje e parimit të humanizmit që e karakterizon, edhe dënimet alternative të dënimit me burgim (nenet 58-65 të KP-së).

45. Nga sa më lart, Gjykata vëren se, pavarësisht ndërhyrjes së ligjvënësit për parashikimin e dy dënimeve kryesore, gjykatat e zakonshme, në bazë të sanksionimit, në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal, të dënimeve plotësuese, si dhe në bazë të parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë, të KP-së, kanë pasur dhe kanë mundësinë e ashpërsimit të dënimit kryesor me një ose disa dënime plotësuese ndaj atyre autorëve të veprave penale rrezikshmëria e të cilëve është e lartë ose të përcaktojnë edhe një masë ndëshkimi me gjobë (në bazë të aftësisë paguese të personit) ndaj autorëve të atyre veprave penale që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, duke realizuar, në këtë mënyrë, qëllimin e ligjvënësit në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet ashpërsimit të masave ndëshkuese. Përpos kësaj, gjykatat e zakonshme, për të garantuar pagimin e dëmeve pasurore që ka pësuar shteti apo i dëmtuari, apo për të siguruar pagimin e shpenzimeve të procedimit etj., mund të vendosin masa të sigurimit pasuror, si sekuestroja konservative.

46. Në këtë rast, Gjykata, duke qenë se shkaku i ashpërsimit të dënimit nga ana e ligjvënësit dhe parashikimi i njëkohshëm i dy dënimeve kryesore ka qenë lufta kundër krimit të organizuar, çmon me vend të analizojë dënimin e përcaktuar për kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 28 i KP-së. Ajo vëren se neni 334 i KP-së, në vetvete realizon qëllimin e ligjvënësit për këto vepra, duke sanksionuar një dënim shtesë prej pesë vjetësh burgim, si dhe gjobë në masën një të tretën.

47. Nga sa më lart, Gjykata çmon se, në vetvete, secili prej dënimeve kryesore të parashikuara nga neni 29 i KP-së, të zbatuara kur është nevoja së bashku me dënimet plotësuese, si dhe me dënimin me gjobë sipas parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së, janë të mjaftueshëm në arritjen e qëllimit të dënimit penal dhe në proporcion me parimet e legjislacionit penal duke respektuar njëkohësisht parimin e ndarjes së pushteteve.

48. Për pasojë, Gjykata çmon se parashikimi *a priori* i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si: falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, jashtë kritereve të analizuara më lart, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar), si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

49. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i gjykatës referuese se parashikimi i dy dënimeve kryesore nga nenet 190 dhe 191 të KP-së, bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës, është i bazuar.

50. Gjykata vëren se plotësimi që iu bë nenit 29 të KP-së nga ligjvënësi me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, lidhur me parashikimin njëkohësisht të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, ka shërbyer si bazë ligjore për të gjitha ndryshimet e ndërmarra më vonë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal për parashikimin e dy dënimeve kryesore në vepra të ndryshme penale përfshirë edhe veprat penale të parashikuara në nenet 190 dhe 191 të KP-së, objekt shqyrtimi. Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se dispozita e mësipërme ka një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim edhe këtë nen.

51. Gjykata konstaton se dispozita e sipërpërmendur, mbart të njëjtat probleme kushtetutshmërie të neneve 190 dhe 191 të KP-së, të konsideruara më lart si të papajtueshme me Kushtetutën.

52. Si konkluzion, Gjykata arrin në përfundimin se nenet 29, paragrafi i fundit, 190 dhe 191, të KP-së që sanksionojnë parashikimin e njëkohshëm të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, vijnë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe si të tillë duhen shfuqizuar.

Për pretendimet e tjera mbi antikushtetutshmërinë e neneve 190 dhe 191 të KP-së

53. Gjykata e Apelit Vlorë ka pretenduar gjithashtu, se parashikimi i dy dënimeve kryesore në nenet 190 dhe 191 të KP-së bie ndesh edhe me nenet 18 dhe 30 të Kushtetutës.

54. Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët dhe grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. *(Shih vendimet nr. 18, datë 29.7.2008, nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese.)*

55. Gjykata, nisur nga argumentet e parashtruara në kërkesë nga gjykata referuese, referimi që ajo bën te neni 18 i Kushtetutës, pa analizuar ekzistencën e pabarazisë për arsye të papërligjura, ndërmjet autorëve të veprave penale që kanë shkelur ligjin penal, të cilët i nënshtrohen vetëm një dënimi kryesor, dhe atyre që u nënshtrohen dy dënimeve kryesore, çmon se pretendimi është i pamjaftueshëm për të provuar dhe për të arritur në përfundimin mbi antikushtetutshmërinë e dispozitave në shqyrtim.

56. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, Kushtetuta parashikon se kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (neni 30 i Kushtetutës). Gjykata është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetues:e nr. 9, datë 28.4.2004; nr. 23 datë 23.7.2009*).

57. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se parashikimi i dy dënimeve kryesore nga dispozitat objekt shqyrtimi cenon parimin e prezumimit të pafajësisë është i paargumentuar dhe se, gjithsesi, nuk ka lidhje me respektimin e këtij parimi dhe, si i tillë, rezulton i pabazuar.

Për pretendimin për shfuqizimin e dispozitave të tjera të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal që parashikojnë dy dënime kryesore

58. Gjykata e Apelit Vlorë ka pretenduar gjithashtu antikushtetutshmërinë e të gjitha dispozitave të tjera të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal që parashikojnë dy dënime kryesore.

59. Sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", gjykata apo gjyqtari është i detyruar, kur çmon se ligji është antikushtetues, të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

60. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka pranuar se ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërish ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata kërkuese, në kuptimin që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese vlerëson, se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë kur mënyra e zgjidhjes së çështjes konkrete, që është në shqyrtim nga gjykata, do të varet nga vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit. Nuk do të ekzistonte lidhja e drejtpërdrejtë nëse

kushtetutshmëria apo jo e normës nuk do të sillte dhe ndryshime për pasojat e mundshme të çështjes (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 4.5.2009*).

61. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se pezullimi i gjykimit nga gjykata referuese lidhet me rezervat që ajo ka mbi kushtetutshmërinë e parashikimit të dy dënimeve kryesore nga nenet 190 dhe 191 të KP-së. Për pasojë, ajo nuk legjitimohet që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për të kërkuar kontrollin kushtetues të të gjitha dispozitave të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal që parashikojnë dy dënime kryesore, pasi nga pikëpamja juridiko-formale nuk ka argumentuar ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet këtyre dispozitave dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69 dhe 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 29, paragrafi i fundit të Kodit Penal.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal në pjesën që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha
Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me pranimin e kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Apelit Vlorë, me pasojë shfuqizimin e nenit 29, paragrafi i fundit, dhe neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal në pjesën që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se është e rëndësishme të shprehim qëndrimin tonë të arsyetuar në lidhje me këtë çështje.

Nga rrethanat e çështjes rezulton se i gjykuari P.R. është dënuar me 4 muaj burgim dhe 300.000 lekë gjobë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kryerjen e veprave penale të "falsifikimit ose përdorimit të vulave, stampave ose formularëve" dhe të "falsifikimit të akteve të gjendjes civile", të parashikuara nga nenet 190/1 dhe 191/1 të KP-së. Në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 59 të KP-së, gjykata ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim për këtë të gjykuar. Kundër këtij vendimi i gjykuari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe ka kërkuar pezullimin edhe të pjesës tjetër të dënimit, atij me gjobë, duke qenë, në këtë rast, të dyja këto dënime kryesore. Gjykata e Apelit Vlorë (gjykata referuese), ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), për t'u shprehur nëse nenet 190 dhe 191 të KP-së dhe të gjitha dispozitat e tjera të pjesës së posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore, janë të pajtueshme me Kushtetutën.

Gjykata ka theksuar se kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) vjen në kundërshtim me Kushtetutën nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen kësaj Gjykate, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e atij ligji. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë

10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton disa kushte që duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, ajo duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke u referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 13, datë 4.5.2009; nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjykimi incidental kërkon edhe raportin e domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Në këtë funksion, kjo e fundit duhet të argumentojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, se në një gjykim incidental, gjykata referuese, nëse arrin në konkluzionin se ligji (dispozita të tij) i kundërshtuar është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, ajo duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, gjykata referuese ka për detyrë të shohë në tërësi pozitat procedurale dhe materiale të palëve dhe gjendjen e tyre pas zgjidhjes së çështjes konkrete. Nëse gjykata ka bazë të arsyeshme të vlerësojë se zgjidhja e çështjes nga ana e saj mund të çojë në cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, atëherë ajo është plotësisht e autorizuar që të referojë çështjen për zgjidhje të problemit të kushtetutshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Të individualizosh çështjen do të thotë, mbi të gjitha, të interpretosh dispozitën e ligjit: funksioni interpretues, si i tillë, nuk i takon kësaj Gjykate, por gjykatës referuese. Është detyrimi i kësaj të fundit të zgjidhë dyshimet interpretative duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës së individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret.

Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Në lidhje me objektin e kërkesës, konstatohet se gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin e nenit 190 dhe 191 të Kodit Penal dhe të gjitha dispozitat e tjera të pjesës së posaçme të këtij Kodi, që parashikojnë dy dënime kryesore, kurse për sa u përket shkaqeve të kërkesës ajo shprehet se këto dispozita bien në kundërshtim me nenet 17, 18 dhe 30 të Kushtetutës. Në përfundim të gjykimit shumica ka vlerësuar se parashikimet e nenit 29, 190 dhe 191 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dhënien e dy dënimeve kryesore, bien në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe ka rrëzuar kërkesën për papajtueshmërinë e këtyre dispozitave me nenet 18 dhe 30 të Kushtetutës, si të pabazuara.

Në çdo rast, nevojitet që nga vendimi i pezullimit të çështjes nga gjykata referuese të dalë qartë rezultati të cilin ajo gjykatë synon të arrijë dhe, në këtë kuptim, ne gjyqtarët në pakicë jemi dakord me qëndrimin e shumicës lidhur me legjitimimin e gjykatës referuese për kundërshtimin e neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal, bazuar në parimin e drejtësisë efektive. Megjithatë, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se, në kuptim të gjykimit incidental, nuk është e mjaftueshme vetëm identifikimi i lidhjes së drejtpërdrejtë, pra të provuarit se norma e kundërshtuar do të zbatohet në çështjen konkrete dhe ndikimi vijues, i vendimit eventual të pranimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, mbi përfundimin e gjykimit të themelit, por është po aq e rëndësishme që vendimi për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatë të arsyetohet nga gjykata referuese edhe nga pikëpamja e bazueshmërisë së çështjes në lidhje me parametrat kushtetuese të referuara si të cenuara nga dispozitat e kundërshtuara.

Në vështrim të standardeve të mësipërme, në çështjen konkrete, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se gjykata referuese nuk ka parashtruar argumente serioze për jokushtetutshmërinë e neneve,

objekt shqyrtimi, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Gjykata referuese pretendon se parashikimi i dy dënimeve kryesore për një vepër penale bie në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi dënimi penal, në aspektin kushtetues, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën, pa dhënë argumente bindëse dhe arsye serioze, në kuptimin kushtetues, për sa i përket cenimit të këtij standardi kushtetues. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se shumica nuk është ndalur siç duhet në verifikimin e elementeve procedurale që duhet të plotësojë kërkesa për inicimin e gjykimit incidental, të elaboruara në jurisprudencën kushtetuese, pasi në parashtrimet e gjykatës referuese mungojnë shkaqet dhe argumentet të cilat përbëjnë bazën ku mbështeten pretendimet për papajtueshmëri me Kushtetutën.

Gjithashtu, është e domosdoshme që gjykata referuese, përpara se t'i drejtohet Gjykatës për kontrollin incidental të normës, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën. Në çështjen konkrete, nenet objekt shqyrtimi duheshin interpretuar nga gjykata referuese jo në mënyrë të shkëputur, por në lidhje me nenet e tjera që parashikojnë llojet e dënimeve dhe caktimin e tyre. Më konkretisht, gjykata referuese, në funksion të interpretimit në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe parimin e proporcionalitetit, duhej t'u referohej neneve 29, 34, 47, 48 dhe 59 të Kodit Penal. Gjykata referuese duhej t'i referohej nenit 29 që parashikon dënimet kryesore, si edhe nenit 34 që parashikon se dënimi me gjobë lejohet të jepet për krime të kryera për motive të fitimit pasuror/përfitimit material. Për sa i përket caktimit të dënimit, gjykata duhej t'i referohej nenit 47 të Kodit Penal, që parashikon se në dhënien e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në nenin 48 dhe nenin 59 të Kodit Penal. Nuk rezulton që gjykata referuese të ketë kërkuar mundësi interpretimi në pajtim me Kushtetutën të dispozitave ligjore përkatëse, në harmoni me dispozitat e tjera të sipërpërmendura, të cilat u lejojnë gjykatave një marzh/kufij vlerësimi të gjerë kur bëhet fjalë për caktimin e dënimit në proporcion me elementet përcaktuese të nenit 47 të KP-së.

Jo vetëm që gjykata referuese nuk ka arritur të parashtrojë argumente kushtetuese që të provojnë cenimin e nenit 17/1 të Kushtetutës, por as shumica, në arsyetimin e saj, nuk ka arritur të japë argumente, se pse dhe në ç'mënyrë është cenuar parimi i proporcionalitetit në rastin konkret. Në vendimin e saj shumica nuk ka analizuar se cilat interesa cenohen nga kryerja e veprave penale të "falsifikimit ose përdorimit të vulave, stampave ose formularëve" dhe të "falsifikimit të akteve të gjendjes civile" dhe sa e rëndësishme është mbrojtja e këtyre interesave, për të arritur më pas në vlerësimin nëse caktimi i dy dënimeve kryesore për këto dy vepra penale është apo jo proporcional. Qëllimin e ligjvënësit, kur ka formuluar tekstin e dispozitave objekt shqyrtimi, shumica e ka identifikuar me luftën ndaj krimit të organizuar, sigurimin e rendit publik e shoqëror, dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale. Veprat penale, objekt shqyrtimi, duke shtrembëruar vërtetësinë dhe autenticitetin e dokumenteve/akteve publike, cenojnë besimin e qytetarëve te shteti dhe veçanërisht te dokumentacioni i lëshuar nga autoritetet shtetërore. Në rastet e kryerjes së këtyre veprave penale nuk cenohen vetëm interesa publikë por edhe interesa privatë të shtetasve për arsye se dokumentet e falsifikuara mund të përdoren në shkëmbime të natyrës financiare, ekonomike apo tregtare midis privatëve. Pikërisht mbrojtja e këtyre interesave të rëndësishme ka qenë dhe qëllimi i legjislatorit në rastin konkret.

Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimet: nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete, si dhe me faktorët e ndryshëm: politikë, historikë, socialë, kulturorë, tradicionalë, të cilët janë përcaktues. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet apo dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se detyra e saj është që të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kritereve ligjore është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet: nr. 1, datë 7.1.2005; nr. 32, datë 21.6.2010; nr.*

28, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrohen argumente bindëse, për t'i dhënë asaj mundësi të vlerësojë, nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet: nr. 16, datë 25.7.2008; nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 31, datë 18.6.2010; nr. 37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kufizimi i lirisë të personit, krahas të drejtave dhe lirive të tjera të parashikuara në Kushtetutë, në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, duhet të bëhet me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit ligjvënësi, lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio",* ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi, aspekte që nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë, bën rregullimin ligjor përkatës, por Gjykata analizon propocionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet, për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ne gjyqtarët në pakicë jemi dakord me qëndrimin e subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, sipas të cilit karakteri i drejtë ose jo i një dënimi nuk lidhet me numrin e efekteve të drejtpërdrejta apo anësore që ai mbart në vetvete, por me përputhjen e tij me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj dhe se parimi i drejtësisë së dënimit nuk lidhet në korrelacion kaq të drejtpërdrejtë mes llojit të dënimit dhe veprës penale, por me sigurimin, brenda respektimit të dinjitetit njerëzor, të një baraspeshimi mes rëndësisë së masës ndëshkuese dhe rëndësisë së veprës penale. Në përcaktimin e veprave penale dhe llojit të dënimit ligjvënësi ka fushë të gjerë veprimi, pasi ai përcakton në ligj veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre, me qëllim për të mbrojtur pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre. Ligjvënësi është përgjegjës për hartimin e politikave penale, pra për marrjen e tërësisë së masave me karakter penal që synojnë të parandalojnë kriminalitetin në një vend dhe një kohë të caktuar, si dhe përcaktimin e strategjisë së përgjithshme të luftës kundër kriminalitetit në vend dhe në këtë drejtim ligjvënësit i njihen hapësira për zgjidhje diskrecionale që i rezervohen vetëm atij. As gjykata referuese në kërkesën e saj dhe as shumica në arsyetimin e vendimit nuk kanë arritur të japin argumente që lidhen me mosplotësimin e kushtit të diktuar nga norma kushtetuese dhe që kërkon që masa e marrë të jetë proporcionale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre.

Sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë. Që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, ai duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën penale. Domosdoshmëria e sanksionit penal është një element i

patjetërsueshëm i rendit juridik pozitiv, por që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer prej tij (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në këtë kuptim gjykata referuese, e legjitimuar për kundërshtimin e neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal, si dispozitat e zbatueshme në rastin konkret, duhet të argumentonte se masa e dënimit e dhënë për veprat penale të parashikuara nga këto dy nene nuk është në përpjesëtim me shkeljen e parashikuar. Pra, e thënë ndryshe, se ashpërsia e dënimit (parashikimi i dy dënimeve kryesore në këto dy nene), është joproporcionale në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj. Ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se gjykata referuese nuk ka arritur t'i ngrejë pretendimet në lidhje me këto dispozita në nivel kushtetues. Në rastin konkret, gjykatës referuese i lindte detyrimi që për secilën nga dispozitat e kundërshtuara të provonte se përcaktimi në Kod i dy dënimeve kryesore (me burgim dhe gjobë) për veprat penale përkatëse, bie në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, duke pasur detyrimin të argumentonte se dënimi penal në rastin e këtyre veprave penale konkrete, në aspektin kushtetues nuk është i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Ajo duhej të argumentonte se dënimi për veprat penale të parashikuara nga nenet 190 dhe 191 të Kodit Penal, duke analizuar rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, nuk është proporcional me veprën penale. Duke mos arritur të argumentojë sa më sipër, gjykata referuese nuk ka përmbushur detyrimin e saj për parashtrimin e shkaqeve për jokushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit Penal, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Ne gjyqtarët në pakicë duam të evidentojmë gjithashtu, se shumica ka pranuar kërkesën duke arsyetuar, se kjo liri e ligjvënësit është e kufizuar kur është fjala për vlerësimin e fajit si element i domosdoshëm i përgjegjësisë penale dhe, në raport me shkallën e tij, për caktimin e llojit dhe masës së dënimit konkret, pasi këto elemente janë të vlerësueshme vetëm nga gjykatat e zakonshme, rast pas rasti. Në këtë drejtim shumica çmon se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Duke pasur parasysh sa më sipër duket se shumica nuk argumenton cenimin e ndalimit kushtetues të kufizimit në kushtet e mosargumentimit të interesit publik, por në thelb i referohet parimit të ndarjes së pushteteve, një pretendim që nuk është ngritur nga kërkuesi dhe si i tillë nuk mund të merret në shqyrtim prej Gjykatës. Ndryshe nga sa argumenton shumica, gjykata nuk pengohet në rastin konkret, për sa i përket individualizimit të dënimit për veprat penale të parashikuara nga nenet 190 dhe 191 të Kodi Penal, përkundrazi, ajo ka një fushëveprimi të gjerë për caktimin e llojit dhe masës së dënimit në përputhje me dispozitat procedurale penale të sipërpërmendura.

Në lidhje me shfuqizimin e paragrafit të fundit të nenit 29 të Kodit Penal, që parashikon se "dënimi me burgim dhe gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi", ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se shumica ka dalë tej objektit të këtij gjykimi. Në thelb shumica argumenton se është në diskrecion të gjykatës që, në kuptim të nenit 34 të Kodit Penal, kur është nevoja, të zbatojë secilin prej dënimeve kryesore të parashikuara nga neni 29 i këtij Kodi së bashku me dënimet plotësuese, si dhe me dënimin me gjobë, duke e konsideruar këtë një mjet të mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit penal dhe në proporcion me parimet e legjislacionit penal. Pra, në thelb, shumica arsyeton se sanksionimi nga ana e ligjvënësit i dy dënimeve kryesore në nenin 29 të Kodit Penal bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës, por ky parim nuk cenohet në rastin e zbatimit nga gjykata të dy dënimeve. Ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se neni 29 nuk gjen zbatim *a priori* për çdo vepër penale, por ai gjen zbatim rast pas rasti, sipas parashikimeve specifike në dispozitat përkatëse të Kodit Penal që rregullojnë veprat e ndryshme penale. Vlerësimi nëse një dënim i caktuar penal, për shkak të kufizimit që përcakton në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është proporcional në raport me gjendjen dhe me shkeljet, për të cilat është parashikuar dhënia e atij dënimi, në rastin konkret parashikimi i dy dënimeve nga ana e ligjvënësit, është një vlerësim që duhet

bërë rast pas rasti, pas shqyrtimit të rrethanave konkrete të çështjes kushtetuese dhe pas marrjes në analizë të elementeve të veprës penale përkatëse, shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave që vijnë nga ajo vepër penale.

Ne gjyqtarët në pakicë ritheksojmë, se raporti midis lirisë interpretuese të gjyqtarit referues dhe veprimtarisë interpretuese të Gjykatës Kushtetuese përfaqëson një çelës për të kuptuar lidhjen midis kërkesave të drejtësisë kushtetuese të gjyqtarit të zakonshëm dhe përgjigjeve që u jep atyre gjyqtari kushtetues. Gjykimi incidental i kushtetutshmërisë ka synim të vendosë rregulla ligjore në përputhje me parimet kushtetuese dhe kërkon që, në një rast konkret kërkesat e drejtësisë të mos plotësohen nga norma e zbatueshme por, përkundrazi, të pengohen nga ajo, pas përpjekjes së gjyqtarit referues për t'i dhënë asaj një interpretim në pajtim me Kushtetutën. Në thelb kërkesa të tilla shprehin qëllimin kryesor të gjyqtarit referues, që është ndryshimi i kuadrit ligjor nëpërmjet largimit të dispozitës që kundërshtohet si jokushtetuese nga rendi ligjor dhe afirmimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese i parimeve kushtetuese që konsiderohen të cenuara nga dispozitat përkatëse. Në këtë kuptim, si gjyqtarët e zakonshëm ashtu edhe ata kushtetues, përfshihen, edhe pse në kufij të përcaktuar mirë, në një lloj "procesi legjislativ". Prandaj, nuk është e mjaftueshme që çështja të ngrihet nga një gjyqtar, gjatë zbatimit të një dispozite ligjore, në një rast konkret, por është e rëndësishme që ai të evidentojë edhe parimet kushtetuese të cenuara, pra të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, pasi Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë gjyqtarin referues, për sa i përket kryerjes së vlerësimit në lidhje me kushtet procedurale që i paraprijnë fillimit të gjykimit incidental të kushtetutshmërisë së normës.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, ne gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se gjykata referuese nuk i ka ngritur në nivel kushtetues pretendimet e saj për jokushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, si dhe nuk ka arritur të argumentojë se ka bërë të gjitha përpjekjet për t'i interpretuar këto dispozita në përputhje me Kushtetutën përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

Në këto kushte, kërkesa e Gjykatës së Apelit Vlorë duhej rrëzuar.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 48, datë 26.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	"	"
Vitore Tusha	Anëtare e	"	"
Sokol Berberi	Anëtar i	"	"
Admir Thanza	Anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	Anëtar i	"	"
Vladimir Kristo	Anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datë 5.6.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 19 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ilir Shijaku, përfaqësuar me deklarim nga avokate Irena Reso.

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në mungesë. shoqëria përmbarimore private "E.P.S.A" sh.p.k. Tiranë, në mungesë. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, përfaqësuar me autorizim nga znj. Aurora Saliasi.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 134/1/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, përfaqësuesen e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesen e subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, detyrë të cilën e ka kryer deri në daljen e aktit administrativ nr. 18/45, datë 5.1.2006, me anë të të cilit, me arsyetimin e ristrukturimit të institucionit, është vendosur lirimi i tij nga detyra dhe kalimi në listën e pritjes.

2. Kërkuesi ka kundërshtuar në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) aktin administrativ të lartpërmendur, i cili me vendimin nr. 118, datë 2.3.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 18/45, datë 5.1.2006 të Sekretarit të Përgjithshëm të METE-s dhe detyrimin e institucionit për kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës.

3. METE ka kundërshtuar vendimin e KSHC-së duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 18/45, datë 5.1.2006 të Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. 11, datë 11.1.2007, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së METE-s dhe lënien në fuqi të vendimit të KSHC. Ndërsa, me vendimin nr. 196, datë 24.5.2007, po kjo gjykatë, me kërkesë të kërkuesit, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 11, datë 11.1.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, mbi bazën e rekursit të paraqitur nga METE, me vendimin nr. 00-2009-626 (115), datë 2.4.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 11, datë 11.1.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Ndërkohë, METE ka shpallur vendin e punës të kërkuesit si vend të lirë, shkak për të cilin kanë filluar procedurat e konkurrimit. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar përsëri KSHC-së me kërkesë për shfuqizimin e procedurave të konkurrimit për vendin e tij të punës.

7. KSHC-ja me vendim nr. 127, datë 27.6.2007, ka vendosur anulimin e procedurave të konkurrimit për vendin e punës së shpallur për konkurrim, vendim i cili u la në fuqi, me vendimin nr. 02, datë 13.1.2010, edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.

8. Gjithashtu, duke qenë se vendimi nr. 11, datë 11.1.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk vihej në ekzekutim nga METE, kërkuesi i drejtohet sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar detyrimin e ministrisë për t'i paguar atij pagën bazë nga data 1.1.2007 deri në ditën e rikthimit të tij në marrëdhënie pune. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4894, datë 14.6.2010, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së kërkuesit.

9. Me vendimin nr. 2834 Akti, datë 20.10.2010, po kjo gjykatë, më kërkesë të kërkuesit ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, kërkuesi, më datë 10.11.2010 i është drejtuar shoqërisë përmbarimore private "E.P.S.A" sh.p.k. Tiranë për ekzekutimin e vendimit nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Shoqëria përmbarimore ka filluar procedurat ligjore përkatëse, duke nisur nga ekzekutimi vullnetar për të vazhduar me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, si dhe duke urdhëruar, me

shkresë nr. 6953 prot., datë 4.10.2011, vënien e sekuestros konservative pranë Degës së Thesarit Tiranë për shumën prej 5.833.952 lekësh (në favor të kërkuesit).

12. Me shkresë nr. 2637/2 prot., datë 31.10.2011, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative, duke bllokuar fondet buxhetore të institucionit debitor, METE, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, në favor të kërkuesit, në vlerën prej 5.833.952 lekësh.

13. Pas këtij veprimi METE depoziton në Degën e Thesarit Tiranë urdhrin nr. 888, datë 10.11.2011, ku ka përcaktuar një grafik për shlyerjen pjesore të detyrimit. Dega e Thesarit Tiranë, në zbatim të pikës 7, shkronja d/1, të udhëzimit nr. 2, datë 18.8.2012 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", heq sekuestron konservative nr. 2637/2 prot., datë 31.10.2011, duke zhbllokuar fondet buxhetore të METE-s.

14. Me shkresë nr. 7102/1 prot., datë 18.11.2011, METE i ka komunikuar edhe shoqërisë përmbarimore "E.P.S.A" sh.p.k. se bazuar në situatën financiare të institucionit, ka programuar shlyerjen në kuotën 10.000 lekë në muaj, në favor të kërkuesit, për periudhën gusht-dhjetor 2011 dhe se ka dorëzuar pranë Degës së Thesarit urdhërpagesën përkatëse.

15. Po ashtu, me shkresën nr. 957/1 prot., datë 20.2.2012 METE i ka komunikuar shoqërisë përmbarimore "E.P.S.A" sh.p.k. se kuota prej 10.000 lekësh në muaj, në favor të kërkuesit, është programuar edhe për periudhën janar-dhjetor 2012.

16. Ndërkohë me urdhër nr. 125, datë 25.2.2011, Ministri i METE-s ka urdhëruar emërimin përkohësisht (për një afat 3-mujor, me të drejtë përsëritje një herë me të njëjtin afat) në detyrë, në vendin e punës së kërkuesit, të znj. E.Z.

II

17. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e METE-s, në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ. Ai pretendon se ka hasur në pasivitetin e subjektit debitor, METE-s, për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me pagimin e pagës. Ai ka parashtruar se shuma e akorduar (në kuotën prej 10.000 lekësh në muaj duke filluar që prej muajit gusht 2011 deri në muajin dhjetor 2012) nga METE është e papërfillshme në krahasim me detyrimin, në vlerën prej 5.833.952 lekësh, në ngarkim të saj. Gjatë seancës plenare, kërkuesi, po ashtu, ka saktësuar se pretendon ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vetëm në lidhje me pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit, duke hequr dorë nga ekzekutimi i vendimit nr. 11, datë 11.1.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë për rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

18. Subjekti i interesuar, ***METE***, me shkresë nr. 4287/1 prot., datë 24.5.2012 ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

18.1. Ekzekutimi i vendimit nr. 4894, datë 14.6.2010, është i pamundur pasi struktura aktuale në fuqi e METE-s ka përcaktuar kritere të reja profesionale për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme.

18.2. Ndërsa në lidhje me detyrimin monetar prej 2.590.836 lekësh, është programuar shuma prej 10.000 lekësh në muaj, pasi Ministria e Financave, përpos kërkesave të vazhdueshme të METE-s, nuk ka akorduar fonde të tjera.

19. Subjekti i interesuar, ***Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit*** ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke paraqitur argumentet e mëposhtme:

19.1. Nuk jemi në kushtet e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi vendimi gjyqësor nr. 4894, datë 14.06.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është në proces ekzekutimi që në fund të vitit 2011. METE pas heqjes së sekuestros konservative, ka zbatuar dhe vazhdon të zbatojë në mënyrë korrekte grafikun për

shlyerjen e detyrimit.

19.2. Institucioni debitor ka marrë masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit, por ka qenë i kushtëzuar nga rrethana të veçanta siç është mungesa e fondeve, e cila gjithsesi mund të ndryshojë në vitin në vijim. Sidoqoftë nga momenti kur vendimi, ekzekutimi i të cilit pretendohet, ka marrë formë të prerë (qershor 2010) e deri në momentin që ka nisur ekzekutimi në nëntor 2011, harku kohor i kaluar nuk mund të konsiderohet si afat i paarsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

20. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Organet shtetërore jo vetëm nuk mund të vënë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por janë të detyruara të marrin masat përkatëse për zbatimin e tyre *(shih vendimet: nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.5.2010, nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj, tashmë ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet: nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 6, datë 4.3.2010 dhe nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Ajo ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Ndërsa për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimet: nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.5.2010, nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

24. Për sa i përket sjelljes (veprimeve) të kërkuesit, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

25. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, në çështjen në shqyrtim, është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore "E.P.S.A." sh.p.k. ka ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura rezulton se kjo shoqëri ka nisur procedurat përkatëse të parashikuara nga ligji procedural, duke nisur nga ekzekutimi vullnetar për të vazhduar me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, si dhe duke urdhëruar, me shkresë nr. 6953 prot., datë 4.10.2011, vënien e sekuestros konservative pranë Degës së Thesarit Tiranë. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se shoqëria përmbarimore "E.P.S.A." sh.p.k. i ka kryer veprimet përmbarimore në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

26. Lidhur me sjelljen e subjektit debitor, Gjykata vëren, se METE ka justifikuar mosekzekutimin e vendimit gjyqësor në ngarkim të saj për shkak të kritereve të reja të strukturës aktuale e cila kërkon që Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të jetë i diplomuar në shkencat Ekonomike, Juridike dhe Shoqërore, ndërsa kërkuesi është inxhinier kimist, si dhe për shkak të mungesës së fondeve. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë seancës plenare, ka saktësuar se ka hequr dorë nga rikthimi në punë i tij, për këtë arsye Gjykata do të analizojë vetëm pretendimet e tij në lidhje me pagimin e pagës.

27. Gjykata ka theksuar se mungesa e fondeve, është argument i pamjaftueshëm dhe nuk justifikon mospagimin e detyrimit ndaj kërkuesit. Kërkuesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga rezultati i favorshëm i procesit gjyqësor, thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit, por ky i fundit duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej jo efektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mosrespektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimet: nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, edhe pse pala debitore, METE, ka shfaqur vullnetin të plotësojë detyrimin ndaj kreditorit duke urdhëruar pagesën e një pjese të tij, Gjykata konsideron se shuma e përcaktuar në mënyrë të njëanshme, në kuotën prej 10.000 lekësh në muaj, duke filluar që prej muajit gusht 2011 deri në muajin dhjetor 2012, për një total prej 180.000 lekësh, është jo proporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustifikuar në raport me masën e plotë të vlerës së detyrimit në favor të kërkuesit (prej 5.833.952 lekësh), gjë e cila cenon në vetvete thelbin e kësaj të drejte dhe shtyn afatin e arsyeshëm në ekzekutimin e vendimit. Gjykata vlerëson se debitori i kishte të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e në vazhdim, t'i paguante kërkuesit shumën që i detyrohej sipas këtij vendimi dhe se nuk rezultojnë arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e së drejtës së kërkuesit.

29. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Admir Thanza, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha

VENDIM
Nr. 49, datë 26.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.6.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pëllumb Qeska

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Korçë, në mungesë; Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Korçë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 3508, datë 24.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f, 134/1/g dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 3508, datë 24.10.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: “*Detyrimin e Seksionit të Financës, Bashkia Korçë, të kompensojë për shpërblim të pashlyer në shumën 947.200 lekë, në favor të paditësit Pëllumb Qeska, për shtëpinë e shpronësuar në vitin 1986.*” Ky vendim ka marrë formë të prerë.

2. Me vendimin nr. 291, datë 20.4.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 3508, datë 24.10.1996.

3. Me shkresën e datës 25.11.2003, Bashkia Korçë i ka dërguar Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit të dhënat për detyrimet që kanë lindur nga vendimet gjyqësore, ku përfshihet edhe detyrimi ndaj kërkuesit.

4. Me shkresën e datës 6.12.2004, Bashkia Korçë i drejtohet Ministrisë së Financave, me kërkesë për akordim fondesh. Me shkresën e datës 28.2.2005, Ministria e Financave i kthen përgjigje Bashkisë Korçë se kjo ministri nuk mund të ekzekutojë vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me nenin 6 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", pasi mungojnë aktet e nevojshme ligjore për këtë qëllim dhe se ky problem do të marrë zgjidhje me rregullimin e kuadrit ligjor.

5. Me kërkesën e datës 7.4.2005, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Korçë për të marrë masa për bllokimin e fondit të çelur për shpronësimet nga Bashkia Korçë dhe shlyerjen e detyrimit ndaj tij.

6. Me shkresën e datës 10.5.2005, Bashkia Korçë i kthen përgjigje Zyrës Përmbarimore Korçë, lidhur me detyrimin ndaj shtetasit Pëllumb Qeska, se nuk mundet ta likuidojë atë, pasi është jashtë mundësive të saj financiare dhe se janë në pritje të çeljes së fondeve nga Ministria e Financave.

7. Me vendimin e datës 24.9.2008, Zyra Përmbarimore Korçë ka vendosur sekuestron konservative në llogarinë e Bashkisë Korçë, në Degën e Thesarit Korçë, për ekzekutimin e vendimit nr. 3508, datë 24.10.1996.

8. Veprimet përmbarimore të Zyrës Përmbarimore Korçë, konkretisht vendimi i datës 24.9.2008 për vendosjen e sekuestros konservative, janë kundërshtuar në gjykatë nga ana e Bashkisë Korçë. Me vendimin nr. 41-2008-2690 (2673), datë 22.10.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit Bashkia Korçë.

9. Me kërkesën e datës 27.11.2008, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Korçë me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3508, datë 24.10.1996. Me vendimin e datës 27.11.2008, Zyra Përmbarimore Korçë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit për vendimin nr. 3508, datë 24.10.1996.

10. Me kërkesën e datës 10.1.2011, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Korçë për rifillimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 3508, datë 24.10.1996.

11. Me shkresën e datës 13.1.2011, Zyra Përmbarimore Korçë i ka dërguar debitorit Bashkia Korçë lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favor të kreditorit Pëllumb Qeska.

12. Me shkresën e datës 7.2.2011, Zyra Përmbarimore Korçë i ka dërguar debitorit Bashkia Korçë lajmërimin për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favor të kreditorit Pëllumb Qeska.

13. Me shkresën e datës 20.2.2011, Zyra Përmbarimore Korçë i ka kërkuar debitorit Bashkia Korçë të paguajë detyrimin ndaj kreditorit Pëllumb Qeska dhe e ka njoftuar se në rast të kundërt do të procedohet sipas ligjit.

14. Me vendimin e datës 2.9.2011, Zyra Përmbarimore Korçë ka vendosur vënien e sekuestros konservative në degën e thesarit Korçë, në llogarinë e debitorit Bashkia Korçë.

15. Me vendimin e datës 10.11.2011, Zyra Përmbarimore Korçë ka vendosur vënien e sekuestros konservative në degën e thesarit Korçë, në llogarinë e debitorit Bashkia Korçë, në zërin "602", në zbatim të titullit ekzekutiv dhe kalimin e shumës objekt i detyrimit në llogarinë e Zyrës Përmbarimore Korçë.

16. ***Kërkuesi Pëllumb Qeska***, me kërkesën e datës 1.3.2012 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar këto shkaqe:

16.1 Nga faktet e paraqitura bashkëlidhur kërkesës konstatohen lehtë mosveprimet e debitorit Bashkia Korçë dhe qëndrimi kontradiktor i saj, e cila ndërsa shprehet se ekzekutimi i vendimeve nuk i përket asaj por Ministrisë së Financave, pasi nuk ka fonde për ekzekutimin, në praktikë vepron krejt ndryshe, duke ekzekutuar vendime të tjera gjyqësore me fondet e veta, të planifikuara në buxhetin e saj.

16.2 Zyra Përmbarimore Korçë, nga ana e saj, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të mëtejshëm ligjor, siç është vendosja e gjobave apo dhe kallëzimi penal ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

16.3 Para presioneve të Bashkisë Korçë dhe premtimeve verbale për ekzekutimin e vendimit, kërkuesi paraqiti pranë Zyrës Përmbarimore Korçë kërkesë për pezullimin e vendimit. Pasi debitori nuk ndërmori asnjë veprim për ekzekutimin e detyrimit, kërkuesi iu drejtua përsëri Zyrës Përmbarimore Korçë për rifillimin e ekzekutimit.

16.4 Edhe pse u vu masa e sekuestros konservative nga ana e Zyrës Përmbarimore Korçë, përsëri ky vendim nuk është ekzekutuar ende dhe, pas mbylljes së vitit, fondet e bllokuara i kalojnë buxhetit të shtetit.

17. ***Subjekti i interesuar Bashkia Korçë***, në parashtrimet e paraqitura me shkrim para Gjykatës, pretendon se:

17.1 Kërkuesi ka kërkuar përmbushjen e një detyrimi që nuk i përket Bashkisë Korçë, fakt që duhej të ishte konstatuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

17.2 Seksioni i Financës pranë Bashkisë Korçë përmendet thjesht si rruga nëpërmjet së cilës do të merret shpërblimi. Fakti që përmendet ky seksion në vendimin e gjykatës nuk e bën atë debitorin e marrëdhënies juridike të detyrimit. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë detyrimin të japin masat e shpërblimeve që vijnë si pasojë e procesit të shpronësimit të banesave private, por këto fonde kanë buruar gjithmonë nga Buxheti i Shtetit.

17.3 Bazuar në VKM-në nr. 335, datë 2.6.1998, Ministria e Financave është organi që zbaton vendimet gjyqësore për kthimin ish-pronarëve të objekteve të privatizuara mbas shtetëzimit si dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ky veprim. Kërkuesi nuk duhet të detyrojë Bashkinë Korçë për përmbushjen e këtij detyrimi, por Ministrinë e Financave.

II

A. Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

18. Gjykata thekson se parimi i shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, të forcojë dhe të zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë (*shih vendimet: nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 13, datë 22.4.2011; nr. 13, datë 21.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në vlerësimin e Gjykatës, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa asnjë vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë

(shih vendimet: nr. 49, datë 21.11.2011; nr. 11, datë 2.3.2012; nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 30, datë 16.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet: nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Kompleksiteti i çështjes

21. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve, duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore *(shih vendimet: nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 10, datë 1.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se çështja objekt shqyrtimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka do të mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji me këtë qëllim.

ii) Sjellja e kërkuesit

22. Gjykata ka theksuar se në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin detyrime monetare ndaj shtetit, personit ndaj të cilit shteti është debitor nuk duhet t'i kërkohet të iniciojë procedura për ekzekutimin e vendimit, me qëllim kompensimin e shumës së caktuar. Në raste të tilla, autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet në mënyrën e duhur për vendimin dhe pra është në pozicionin të marrë të gjitha masat për ta përmbushur atë ose t'ia transmetojë një autoriteti tjetër shtetëror që është kompetent për ekzekutimin (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Ai i është drejtuar debitorit për ekzekutimin e vendimit, ka bërë ankesa në institucione të ndryshme si: Gjykata Kushtetuese, Ministria e Financave, Avokati i Popullit dhe pasi nuk ka arritur ekzekutimin vullnetar i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Korçë për të vënë në lëvizje procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. Gjykata thekson se kërkuesi, i cili është pajisur me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi sepse, për shkak të shkaqeve të ndryshme, kërkoi pezullimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të këtij vendimi për një periudhë dyvjeçare 2009-2011. Për më tepër, siç shprehet edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), një person, i cili pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohet t'u drejtohet organeve përmbarimore për të ekzekutuar vendimin (*shih vendimin e GJEDNJ-së, datë 22.8.2006, në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*). Në përfundim, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve publike

24. Lidhur me sjelljen e autoriteteve publike, Gjykata vëren se në këtë drejtim duhet të shqyrtohet sjellja e secilit autoritet të përfshirë në këtë proces. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër, vazhdimisht, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse duhet të mbrohen efektivisht të drejtat dhe të respektohet shteti i së drejtës, autoritetet administrative janë të detyruara, rrjedhimisht, të ekzekutojnë vendimet e formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose

vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë, që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, e humbasin qëllimin e tyre (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kërkuesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit. Në këtë drejtim, në rastet kur debitor është vetë shteti, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve, si justifikim për të mosrespektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet: nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se nga ana e debitorit Bashkia Korçë është nxjerrë si justifikim për mosekzekutimin e detyrimit pikërisht mungesa e fondeve, duke mos bërë përpjekje për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që ka ndaj kërkuesit. Gjykata vëren se bazuar në nenin 9 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999), "*Bashkësitë vendore kanë të drejtë në kuadrin e politikës ekonomike të vendit, të kenë burimet e tyre të mjaftueshme, të cilat mund t'i disponojnë lirisht në ushtrimin e kompetencave të tyre*". Me marrjen dijeni të detyrimit financiar që rridhte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, debitori Bashkia Korçë duhej të merrte të gjitha masat për ekzekutimin e tij dhe nuk duhej të priste vënien në lëvizje të procedurave të përmbarimit, deri në marrjen e masave shtrënguese.

26. Në parashtrimet me shkrim drejtuar kësaj Gjykate, Bashkia Korçë pretendon, gjithashtu, se nuk është ai subjekti që duhet të detyrohet për përmbushjen e detyrimit. Këtë pretendim rezulton që kërkuesi ta ketë ngritur edhe më parë në gjykatat e zakonshme, duke iu drejtuar me padi gjykatës për kundërshtimin e veprimeve të Zyrës Përmbarimore Korçë. Me vendimin nr. 41-2008-2690 (2673), datë 22.10.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka rrëzuar padinë si të pabazuar, duke vlerësuar se pretendimi sipas të cilit përmbushja e detyrimit nuk i përket Bashkisë Korçë nuk mbështetet në ligj dhe se moskoordinimi mes këtij institucioni dhe Ministrisë së Financave, apo mungesa e rregullimit ligjor për këtë marrëdhënie, nuk përbën shkak për kundërshtim në përmbushjen e këtij detyrimi. Në këto kushte, këtij pretendimi i është dhënë përgjigje me një vendim të arsyetuar të gjykatës.

27. Lidhur me sjelljen e organit të caktuar nga ligji për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Zyra Përmbarimore Korçë, edhe pse ka marrë masa shtrënguese, siç është vendosja e sekuestros konservative në llogarinë e debitorit, veprimet e saj kanë rezultuar të pamjaftueshme për të siguruar përmbushjen e detyrimit që ka lindur nga një vendim gjyqësor i formës së prerë në favor të kërkuesit. Gjykata rithekson se përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 589 të KPC-së, ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët dhe, kur nuk ka të tilla, në llogari të thesarit. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi tek të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi, ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se veprimet e Zyrës Përmbarimore kanë qenë formale dhe ajo nuk ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion. Zyra Përmbarimore duhej të zbatonte nenin 589 të KPC-së që i referohet specifikisht ekzekutimit të detyrimeve në të holla të institucioneve buxhetore, e cila i njeh të drejtën këtij subjekti, kur është rasti, t'i kërkojë vetë organit epror çeljen e fondeve me qëllim ekzekutimin e detyrimeve. Po ashtu, Zyra Përmbarimore mund të aplikonte edhe sanksione ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin, mjet ligjor që rezulton të mos jetë përdorur nga ky subjekt. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Zyra Përmbarimore Korçë nuk ka kryer të gjitha veprimet e njohura nga ligji për të siguruar zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

28. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga ana e debitorit Bashkia Korçë. Gjykata vlerëson se, nëpërmjet sjelljes së tyre, organet shtetërore kanë cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 3508, datë 24.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.8.2012
Doli nga shtypi më 14.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë